



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:215489

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525385

PPP.nr.137/19

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen përbarimore të kreditorit K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” me seli në Prizren, kundër debitorit F.T.nga fshati B./Malishevë, për pagesën e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm (faturave) në shumën prej 2,098.15 euro, sipas urdhrin P.nr.324/2016 të datës 26.07.2016 për lejimin e propozimit përbarimor të përbaruesit privat Mehdi S. Reshani me seli në Prizren, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. ANULOHET** urdhri përbarimor P.nr.324/2016 i datës 26.07.2016 i lejuar nga përbaruesit privat Mehdi S. Reshani për territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, si dhe të gjitha veprimet përbarimore të ndërmarra në këtë procedurë, si të palejueshme.
- II. HEDHET POSHTË** si i palejueshëm propozimi/kërkesa e kreditorit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm P.nr.324/2016 i datës 26.07.2016, të propozuarit B.T. nga fshati B./Malishevë për debitorin/të ndjerin F.S.T.nga fshati B./Malishevë.

A r s y e t i m

Kreditori K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” me seli në Prizren, më datë 26.07.2016, ka parashtruar propozim për përbarim ndaj debitorit F.T.nga fshati B./Malishevë, duke kërkuar që në emër të borxhit të faturuar deri në muajin 06 të vitit 2016, sipas ekstraktit të verifikuar nga librat afariste (faturave), debitori t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,098.15 euro, si dhe shpenzimet e përbarimit nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Përbaruesi privat Mehdi S. Reshani me seli në Prizren, me urdhrin përbarues P.nr.324/2016 të datës 26.07.2016, ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përbarimore.

Kreditori me datën 06.02.2018, ka paraqitur propozimin kurse me datën 15.11.2019 e ka aprovuar kërkesën për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, ashtu që pas verifikimit se

debitori në këtë çështje ka vdekur, ka kërkuar që si përfaqësues i përkohshëm t'i caktohet B.T.. Nuk ka bashkangjitur dëshmi për vërtetimin e faktit se debitori F.T.ka vdekur.

Gjykata pas marrjes së informacionit se debitori në këtë çështje përmbarimore ka vdekur, me qëllim të vlerësimit lidhur me legjitimitetin e debitorit në këtë çështje përmbarimore, ka kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Malishevë që ta konstatoj këtë fakt, për çka të njëjtit, me datën 27.11.2024 na kanë dërguar Certifikata e Vdekjes me nr. reference V ... për debitorin F. (S.) T., ku konstatohet që i njëjti ka vdekur me datën 24.06.2014 në B..

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës erdhi në përfundim se propozimi për përmbarim, e po ashtu urdhri për përmbarim janë të palejueshëm nga faktet si në vijim:

Me nenin 2 paragrafi 1 pika 1.6 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, është paraparë se: *“Palë - kreditori apo debitori në procedurën përmbaruese”*, kurse neni 17 i LPP-së ka paraparë që: *“Në procedurën përmbarimore përshatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*.

Neni 73 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka paraparë: *“Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik”*, kurse me nenin 76 të LPK-së, është paraparë se: *“Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm”*, ndërsa në nenin 78 par.1 dhe 4 është përcaktuar se: *“1. Kur gjykata konstaton se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, dhe se kjo mungesë mund të evitohet, do ta ftojë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndër marrë masa të tjera me qëllim që procedura të mund të vazhdohet me personin që mund të jetë palë në procedurë”* dhe paragrafi 4: *“Po që se të metat e treguara nuk mund të mënjanoen, apo në qoftë se afati i caktuar nga gjykata kalon pa sukses, gjykata me aktvendim i abrogon veprimet e kryera po që se janë përfshirë me të metat në fjalë dhe do ta hedhë poshtë padinë, po që se të metat kanë natyrë të tillë që pengojnë procedimin e mëtutjeshëm të çështjes”*.

Nisur nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me urdhër të lejuar nga Përmbaruesi Privat ndaj një personi i cili nuk mund të paraqitet si palë në procedurë, kjo nisur nga fakti që debitori në këtë çështje përmbarimore ka vdekur para se të dorëzohet propozimi për përmbarim ndaj tij, fakt ky i provuar nga certifikata e vdekjes, me numër të referencës V ..., me numër rendor 22, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në M., me datën 27.11.2024.

Pra, gjykata gjeti se në rastin konkret nuk ka mundur të kërkoj nga kreditori që të evitoi të metat në lidhje me legjitimitetin real pasiv të palës, ngase një e metë e tillë nuk ka mundur të mënjanohet për faktin se debitori F.T.nga fshati B./Malishevë, si palë në këtë procedurë, ka vdekur me datë 24.06.2014 ose para fillimit të procedurës, gjegjësisht para paraqitjes së propozimit për përmbarim me datë 26.07.2016, ashtu siç u vërtetua me Certifikatën e Vdekjes me Nr.Ser. V 30/2014RV/30010.

Nga arsyet e lartcekura, gjykata ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejueshëm propozimin/aprovimin e kreditorit për caktim të përfaqësuesit të përkohshëm, si dhe ta anuloj urdhrin për përmbarim P.nr.324/2016 të datës 26.07.2016 si të palejueshëm, pasi që procedura nuk mund të fillohet, zhvillohet dhe përfundoj ndaj një personi i cili nuk është në jetë, pasi që legjislacioni ka paraparë situatën e marrjes së të drejtave dhe detyrimeve nga ana e pasardhësve me rastin e vdekjes së një personi, e të cilat situata janë formale në kuptim të zhvillimit të procedurës gjyqësore.

Pasi që procedura nuk mund të iniciohet kundër personit të vdekur, i cili në momentin e vdekjes ka humbur zotësinë juridike për të qenë palë në procedurë, gjykata në bazë të nenit 78 par.4 të LPK-së e ka anuluar urdhrin përmbarimor dhe të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë, duke gjetur se kjo mungesë është e asaj natyre e cila e ndalon udhëheqjen e mëtejme në këtë çështje përmbarimore.

Nga arsyet e paraqitura më lart, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë, Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil
PPP.nr.137/19, datë 29.11.2024

Gjyqtari
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.